



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Zyra e Tatimit në Pronë

Junik: 23.01.2023

NJOFTIM

Të nderuar tatimpagues, ju njoftojmë se kalkulimi i faturave për Tatimin në pronë për vitin 2023 ka përfunduar me sukses. Edhe këtë vit shpërndarja e faturave do të bëhet nga PTK-ja.

Zyra e Tatimit në pronë, në komunën e Junikut është e hapur çdo ditë, ju mund të drejtoheni në çdo kohë për çdo paqartësi të mundshme në lidhje me faturat e Tatimit në pronën e paluajtshme.

Gjithashtu, kërkojmë nga të gjithë Tatimpaguesit të cilët kanë obligime tatimore të pa paguara t'i kryejnë obligimet e tyre pasi që Tatimi mbi pronën është detyrim ligjor dhe i pa shmangshëm.

Çdo përgjigje pozitive ndaj Tatimit në pronë, e ndihmon komunën në realizimin e projekteve, si dhe e largon mundësinë e marrjes së **vendimit për ekzekutimin e detyrimeve Tatimore të papaguara me propozimin për përmbarim (apo mbledhje të detyrueshme).**

Për pagesë ju lutem kërkon faturen në **Zyren e Tatimit në Pronë**, apo dhe në linkun **e-Kosova** linku: <https://ekosova.rks-gov.net>